



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:243103

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05876768

C.nr.1630/2014

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Valentina Sopjani, me bashkëpunëtorin profesional Fiton Haklaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Qeveria e Kosovës – Minsitria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Naime Abazi, avokate pranë Avokaturës Shtetërore, kundër të paditurit A.N nga fshati B....., Komuna e Prishtinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mentor Neziri, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti pasurim i pabazë, vlera e objektit të kontestit 43,225.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 19.04.2024, me datë 03.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, DETYROHET i padituri A.N, që paditëses, në emër të pasurimit të pabazë, t ‘ia kompensojë shumën prej 16,022.50 euro, me kamatë ligjore prej 7% në vit, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë 03.06.2014, e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes – pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses Qeveria e Kosovës – Minsitria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET i padituri A.N, që paditëses, t ‘ia kompensojë shumën prej 27,202.50 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.”, SI E PABAZUAR.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësja në këtë gjykatë me datë 03.06.2014, ka paraqitur padi kundër të paditurit A.N, për shkak të kthimit të mjeteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme.

Paditësja, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarit të saj, ka theksuar se paditësja Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në kuptim të Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.. 03/2013 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ka vendosur që të mbështesë fermerin tani të paditurin A.N nga fshati B....., KK Prishtinë dhe se qëllimi i këtij projekti ishte përkrahja e përfituesit për të ristrukturuar potencialin fizik në sektorin agro – rural në Kosovë. Tutje ka shtuar se pas marrjes së një informate në të cilin është apostrofuuar paditësja, lidhur me grantin të cilin e ka financuar për fermerët me projektin për mekanizëm – traktor, Agjencia për Zhvillim Rural ka marrë masat konform ligjit, kështu që me datë 26.02.2014 ka zhvilluar një supër kontrollë tek i padituri A.N dhe gjatë supër kontrollës është vërtetuar se traktori i tipit Belarus MTZ 100KË i blerë tek K.B “A.....” me seli në Vushtri, me faturë nr. 75/13 të datës 29.11.2013 të ofruar nga fermeri A.N tek AZHR në vlerë prej 52,00.00 euro, i njëjti traktor ka vlerën e tregut 33,000.00 euro, përderisa në AZHB çmimi i pagesës është bërë në shumën prej 51,900.00 euro. Më tej ka theksuar se vlera totale e pranueshme për përfituesin e projektit arrin shumën prej 66,500.00, ku 65% e kësaj vlere, përkatësisht shuma prej 43,225.00 euro, është financuar nga paditësja e cila shumë pas përfundimit të gjitha procedurave administrative është paguar sipas vendimit për mbështetje 07/04/801/2013 i datës 13.12.2013, përderisa në çmim real i padituri është dashur ti marrë 27,202.50€, me ç ‘rast paditësja ka nxjerrë vendimin 07/4/801/2013 të datës 25.03.2014 ku janë ri caktuar vlerat ku vlera e investimit nga 66,500.00€, është ndryshuar në 41,850.00€, kurse vlera e mbështetjes prej 65% është zvogëluar në 27,202.50€, andaj shuma që është dashur të kthejë fermeri kap vlerën prej 16,022.50€. Tutje ka shtuar se paditësja me kërkesës i është drejtuar të paditurit për kthimin e mjeteve, mirëpo i njëjti këtë kërkesë e ka kundërshtuar, dhe duke qenë se i njëjti ka kundërshtuar kthimin e të njëjtave. Andaj mbi këtë bazë paditësja në kuptim të nenit 27 paragrafi 2 të UA nr. 03/2013 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, nenit 38 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe nenit 7 të Kontratës ndërmjet palëve ndërgjyqëse, i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesëpadi e paditëses dhe të detyrohet i padituri A.N që në emër të mjeteve të

fituara në mënyrë të kundërligjshme të paguajë paditëses shumën prej 43,225.00, me kamatë ligjore prej 7% në vit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes - pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarit të tij, ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses për nga baza juridike, me arsyetimin se i padituri ka qenë përfitues i projektit, ku bazuar në këtë projekt ka blerë një traktor të tipit “Belarus” MTZ 100 KË, tek “A.....”, me seli në Vushtri, me çmimin prej 52,000.00€ si dhe mjete tjera të punës në shumën prej 16.900.00€, ashtu që shuma e përgjithshme kap vlerën prej 68,900.00€. Ka shtuar se këto mjete i ka blerë pasi që ka pranuar 3 oferta me çmime të një traktori si të blerë nga i padituri apo për afërsisht të njëjtë dhe duke qenë se oferta më e përshtatshme ka qenë nga A....., këto mjete i ka blerë nga ky ofertues, pra e kundërshton pretendimin se fatura nr. 75/13, datë 29.11.2013 përmban çmimin jo real të tregut për traktorin e blerë me çka paditësja është mashtruar, si fakt të pambështetur në prova. Përveç këtyre ka shtuar se Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr. 510/2023 të datës 20.09.2023 me të cilën është refuzuar aktakuza e Prokurorisë, e ushtruar ndaj këtu të paditurit për shkak të veprës penale Mashtrim me subvencione, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale, me çka nuk është vërtetuar fakti se i padituri ka mashtruar këtu paditësen lidhur me çmimin real të mjetit të blerë. Mbi bazën e këtyre i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses, ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Formulari për aplikim i datës 12.03.2013, aplikacioni për regjistrim i datës 31.10.2013, mbledhja e treguesve për projektimin e mekanizmi bujqësor në 16 faqe, certifikata e numrit fiskal i datës 14.12.2009, projektin për mekanizmin bujqësor i datës 24.04.2013, letër informimi i datës 04.11.2013, raporti i kontrollit i datës 31.05.2013, raporti i kontrollit në terren i datës 31.10.2013, raporti i vlerësimit të inspektoratit i datës 13.12.2013, konstatimi i inspektorëve i datës 26.02.2014, lista kontrolluese për pagesë pjesa I, kërkesa për pagesë e datës 10.12.2013, lista kontrolluese për pagesë pjesa II e datës 25.03.2014, lista kontrolluese për pagesë pjesa III në dy fatura, raporti i vlerësimit për mallra dhe punime i datës 29.11.2013, ftesa për kuotim e datës 14.11.2013, 13.11.2013, 11.11.2013;

16.11.2013, oferta me nr.351 e datës 14.11.2013, fatura nga Haxhi Jaha nr.236/13, fatura nga “A.....” nr.119/13, kontrata e datës 29.11.2013, vendimi me nr.801/2013 i datës 19.12.2013, kontrata e datës 04.11.2013, ndryshim – plotësimi i vendimit nr.07/4/065/2014, kërkesa për kthim të mjeteve e datës 01.04.2014, urdhërpagesa e datës 20.04.2016; 24.12.2013, oferta nr.351, aktakuza me nr.PP/2.nr.1946/2015 e datës 24.04.2019, aktgjykimi PA1.nr.510/2023 i datës 20.09.2023, kërkesa për pagesë të subvencioneve e datës 26.11.2013, vendimi nr. ZSP 0171/13 i datës 24.12.2013, lista e fermerëve përfitues e datës 19.12.2013 dhe dëgjimin e të paditurit në cilësinë e palës.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses duhet të aprovet pjesërisht si e bazuar, për arsyet se:

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësja në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës –(tutje PZHRB) 2007 – 2013, ka hapur Masën e 2 të quajtur Ristrukturimi i potencialit fizik të sektorit agro-rural përmes të cilit projekt investuesi do mbështetej nga paditësja në 65 % të vlerës investive, në të cilën kishte aplikuar edhe këtu i padituri A.N në cilësinë e pronarit të Biznesit Individual me emrin A.N dhe numër të biznesit 7....., fakt i cili vërtetohet edhe nga Formulari për aplikim i datës 12.03.2013 me dokumentet përcjellëse aplikacioni për regjistrim i datës 31.10.2013, mbledhja e treguesve për projektimin e mekanizmi bujqësor në 16 faqe, certifikata e numrit fiskal i datës 14.12.2009 dhe projekti për mekanizmin bujqësor i datës 24.04.2013.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese as fakti se i padituri ka blerë mjetet për investim dhe atë traktorin 100KW, të tipit “Belarus” MTZ në vlerë prej 51,900.00 euro, plugje me vlerë prej 3,800.00 euro, pijatore të mëdha në vlerë prej 4,900.00 euro dhe rimorkia transportuese me vlerë prej 6,000.00 euro, fakte të cilat vërtetohen nga fatura nr. 75/13, datë 29.11.2013, kontrata e datës 29.11.2013 e lidhur ndërmjet këtu të paditurit A.N në cilësinë e përfituesit dhe K.B “A.....” në cilësinë e Kompanisë,

Nuk ishte kontestuese as fakti se të paditurit i është pranuar vlera e investimit në shumën prej 66,600.00 euro, fakt i cili vërtetohet nga letër informimi i datës 04.11.2013.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se i padituri A.N, për shitblerjen e traktorit kishte marre tri oferta, ku oferta e dhënë sipas ofertës me numër 351 e datës 14.11.2013 ka qenë në shumën prej 71,000.00 euro, kurse nga fatura nr. 236/13 shuma e ofertuar e traktorit

ka qenë 71,800.00 euro dhe fatura nga “A.....” nr. 119/13 shuma e ofertuar e traktorit ka qenë në shumën prej 52,000.00 euro, kështu që i padituri ka zgjedhur ofertuesin më të lirë dhe atë “A.....”, me ç ‘rast për shitblerjen e këtyre mjeteve kishin lidhur dhe kontratën e vërtetuar tek organi kompetent, fakte të cilat u vërtetuan edhe me provat oferta me nr.351 e datës 14.11.2013, fatura nga Haxhi Jaha nr.236/13 dhe fatura nga “A.....” nr.119/13 si dhe kontrata e datës 29.11.2013.

Nuk ishte kontestuese as fakti se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (tutje AZHB), përmes inspektorëve kishte bërë kontrollin në terren, ku është konstatuar gjendja faktike se fermeri A.N ka të mbjellura 25 ha me grur, me misër dhe kultura tjera mbi 13 ha dhe se fermeri në fjalë ka realizuar projektin në fjalë duke blerë traktorin të tipit Belarus MTZ – 100KË, me ID 12101176 dhe nr, serik 327451 viti i prodhimit 2013, pijatoret prej 32 disqeve, rimorkion transportuese dhe plugjet, fakt i cili vërtetohet edhe nga raporti i kontrollit i datës 31.05.2013, raporti i kontrollit në terren i datës 31.10.2013, raporti i vlerësimit të inspektoratit i datës 13.12.2013.

Për gjykatën fakt jo kontestues ishte edhe fakti se, paditësja ka vendosur të mbështesë fermerin, këtu të paditurin A.N, në shumën maksimale për investimin e pranueshëm në vlerë prej 66,600.00 euro, me 65 % të vlerës investuese, gjegjësisht në shumën prej 43,225.00 euro, fakt i cili vërtetohet edhe me vendimin me nr.801/2013 i datës 19.12.2013 dhe kontratën e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse e datës 04.11.2013.

Nuk ishte kontestuese as fakti se të paditurit i është paguar vlera mbështetëse sipas vendimit të lart cekur dhe atë në shumën prej 43,225.00 euro, fakt i cili u vërtetua edhe nga kërkesa për pagesë të subvencioneve e datës 26.12.2013, urdhërobiligimi për pagesë me numër të referencës 203132409 përmes të cilës përfitojnë personat sipas listës të fëmërëve përfitues për masën 2 me numër të referencës 07/4. 4510 e datës 19.12.2013, në të cilën listë figuron edhe i padituri me numër rendor 68. Fakti se të paditurit i është paguar shuma mbështetëse në vlerën prej 43,225.00 euro, gjykata e vërtetoi edhe përmes pohimit të paditurit i cili kishte theksuar se *“Pas një kohe në llogarinë tonë janë rimbursuar rreth 50,000.00 euro dhe është rimbursuar komplet granti (prej 65%) të vlerës.”*

Fakti i lart cekur u vërtetua edhe nga lista kontrolluese për pagesë pjesa I, kërkesa për pagesë e datës 10.12.2013, lista kontrolluese për pagesë pjesa II e datës 25.03.2014 dhe lista kontrolluese për pagesë pjesa III në dy fatura.

Paditësja pas pretendimeve se çmimi i traktorit të blerë nuk ishte real, me datë 26.02.2014, tek i padituri kishte realizuar super kontrolle, nga e cila është konstatuar se me rastin e super

kontrollës fermeri këtu i padituri A.N ka traktorin dhe pajisjet e tjera me të dhëna të njëjta sipas kontrollit paraprak, fakt i cili vërtetohet nga konstatimi i inspektorëve i datës 26.02.2014.

Përmes vendimit 07/4/065/2014 të datës 25.03.2014 për ndryshim – plotësimin e vendimit nr.07/4/801/2013, gjykata vërtetoi faktin se Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë kishte ndryshuar pikën 4 të vendimit bazë nr.07/4/801/2013 dhe atë shumën maksimale investive nga 66,500.00 euro (e njohur fillimisht), në 41,850.00 euro dhe pikën 7 të njëjtit vendim lidhur me shumën mbështetëse prej 65 % të shumës investive dhe atë nga shuma 43,225.00 euro (e cila i është paguar paditësit) në 27,202.50 euro.

Përmes leximit të kërkesës për kthim të mjeteve e datës 01.04.2014, gjykata vërtetoi faktin se AZHB-ja i është drejtuar të paditurit me kërkesë për kthimin e mjeteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme, si dhe për shkak të ri kalkulimit të pagesave për traktor sipas listës së re të çmimeve të kthehen mjetet në shumën prej 16,022.50 euro.

Nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PA1.nr.510/2023 i datës 20.09.2023, u vërtetua fakti se ndaj këtu të paditurit, me aktgjykim të formës së prerë është refuzuar akti akuzues, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale për veprën penale Mashtrimi me subvencione nga neni 336 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së.

Gjykata ka dëgjuar të paditurin A.N në cilësinë e palës i cili kishte deklaruar se pas shpalljes së grantit kam aplikuar, ku kam përpiluar projektin duke përfshirë të gjithë dokumentacionin dhe jemi shpallur përfitues të grantit në vlerë prej 68,000.00 euro. Pastaj kemi dërguar të gjithë dokumentacionin në Ministri, kemi bërë shpalljen në gazetë për paraqitjen e ofertuesve ku pas kalimit të afatit ligjor janë paraqitur 3 ofertues të cilët i kemi dërguar në Ministri. Në bashkëpunim me Ministrinë e kemi zgjedhur njërin nga ofertuesit i cili ka qenë më i liri, ku tani pas përzgjedhjes kemi qenë të obliguar të lidhim kontratë tek noteri me përfituesin e përzgjedhur. Përfituesi i përzgjedhur ka qenë “Agro Vini”, nga i cili kemi blerë mjetet në shumën prej 68,900.00 euro, ku pas lidhjes së kontratës kemi qenë të obliguar që të kryejmë pagesën në emër të kontraktuesit, ku kemi paraqitur edhe dëshmi. Ku pas paraqitjes së kërkesës për rimbursim, personat zyrtar të Ministrisë, kanë dalë në terren tri herë në vazhdimësi nga inspektor të ndryshëm, ku nga ana e tyre çdo gjë ka qenë në rregull në përputhje me dokumentacionin e paraqitur. Pas kalimit të një kohe në llogarinë tonë janë rimbursuar rreth 50,000.00 euro dhe është rimbursuar komplet granti (prej 65%) të vlerës. Pas një kohe kam pranuar një vendim për kthimin e mjeteve nga Ministria, i cili ka qenë për vlerën 16,022.50 euro.

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe çështje për argumentim ligjor paraqitet të jetë baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, përkatësisht vlerësimi i faktit nëse i padituri ka mashtruar paditësen me rastin e paraqitjes së faturës 75/13 të datës 29.11.2013 për çmimin e shitblerjes së traktorit Belarus MTZ – 100KW, ku fatura përmban shumën prej 51,900.00 euro, kurse paditësja pretendon se çmimi real i tregut i këtij traktori vlerësohet në shumën prej 33,000.00 euro.

Baza ligjore

Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 2 të LPK-së e cila përcakton “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale” e lidhur me nenin 253 paragrafi 2 të LPK-së e cila parasheh “Gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë.”, gjykata vlerëson se bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, e drejta materiale e cila duhet aplikuar në rastin konkret paraqitet Ligji Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet E Detyrimeve (tutje LMD).

LMD-ja në nenin 194 të saj parasheh “*Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur. 2. Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve. 3. Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket.*

Si dhe neni 245 i LMD-së e cila përcakton parimin e përgjithshëm e të drejtës së kreditorit dhe detyrimit të debitorit në marrëdhëniet e detyrimeve “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës në raport me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë

LMD-ja në nenin 194 të saj, parasheh faktin juridik të krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve dhe atë faktin e pasurimit të pabazë, e cila në rastet praktike vjen në shprehje në rastet kur plotësohen në mënyrë kumulative elementet ligjore të saj dhe atë pasurimi i personit tjetër, varfërimi i personit tjetër, lidhja kauzale mes varfërimit dhe pasurimit dhe elementi i fundit mungesa e bazës juridike apo dhe pranimi i prestimit në lidhje me një bazë që më vonë ka dështuar.

Sa i përket elementit të parë dhe atë pasurimi i personit tjetër cilësohet në formën rritjes së pasurisë së personit tjetër e që në rastin konkret është vërtetuar se në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës –(tutje PZHRB) 2007 – 2013, ku është hapur Masën e

2, të quajtur Ristrukturimi i potencialit fizik të sektorit agro-rural përmes të cilit projekt investuesi do mbështetej nga paditësja në 65 % të vlerës investive, këtu i padituri ishte pasuruar në formën e rimbursimit prej 65 % të vlerës investuese 66.600.00 euro, gjegjësisht është pasuruar në shumën prej 43,225.00 euro, fakte të cilat u vërtetuan nga urdhër obligimi për pagesë me numër të referencës 203132409 përmes të cilës përfitojnë personat sipas listës të fermerëve përfitues për masën 2 me numër të referencës 07/4. 4510 e datës 19.12.2013, në të cilën listë figuron edhe i padituri me numër rendor 68, fakt i vërtetuar dhe përmes pohimit të paditurit i cili kishte theksuar se *“Pas një kohe në llogarinë tonë janë rimbursuar rreth 50,000.00 euro dhe është rimbursuar komplet granti (prej 65%) të vlerës, e që në këtë kuptim plotësohen edhe elementet e varfërimit të personit tjetër këtu paditëses dhe lidhjes kauzale mes pasurimit dhe varfërimit, kjo sepse shuma prej 43,225.00 euro është paguar nga mjetet e paditëses tek i padituri.*

Në raport me elementin e mungesës së bazës juridike apo pranimi i prestimit në lidhje me një bazë që më vonë ka dështuar, në vlerësimin e gjykatës në rastin konkret shprehet kjo e dyta, sepse nga gjendja faktike e vërtetuar, prestimi i pranuar nga paditësi prej të paditurës në shumën prej 43,225.00 euro ka ardhur si pasojë e vendimit nr.07/4/801/2013 të datës 19.12.2013 për Mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural, ku në pikën 7 të këtij vendimi pas miratimit të kërkesës për pagesë dhe autorizimit për pagesë, është obliguar Ministria që shumën financiare prej 43,225.00 euro ta transferojë në llogarinë e këtu të paditurit, i cili vendim më pastaj *(duke i pasur parasysh pretendimet e të paditëses së është mashtruar me çmimin e shitblerjes së traktorit)* është ndryshuar me vendimin 07/4/065/2014 të datës 25.03.2014 për ndryshim – plotësimin e vendimit nr.07/4/801/2013, përkatësisht në pikën 4 të vendimit bazë nr.07/4/801/2013 dhe atë shumën maksimale investive nga 66,500.00 euro (e njohur fillimisht), në 41,850.00 euro dhe pikën 7 të njëjtit vendim lidhur me shumën mbështetëse prej 65 % të shumës investive dhe atë nga shuma 43,225.00 euro (e cila i është paguar paditësit) në 27,202.50 euro.

Pra nga vendimet e lartcekura del se paditësi fillimisht nga një bazë ligjore ka fituar shumën prej 43,225.00 euro, e cila më pastaj me një vendim të lëshuar nga vetë paditësja, kjo shumë është ndryshuar në 27,202.50 euro, e që rrjedhimisht i bie që i padituri shumën prej 16,022.50 euro e mban nga një bazë që më vonë ka dështuar, përkatësisht në rastin konkret është ndryshuar.

Andaj nga një gjendje e tillë e fakteve, në vlerësimin e gjykatës, kërkesëpadia e paditëses gjen mbështetje në bazën juridike të pasurimit të pabazë, ashtu që kundërvlera mes shumës së aprovuar fillimisht (43,225.00) në shumën e ndryshuar pastaj (27,202.50), del në shumën prej

16,022.50 euro si shumë e fituar pa bazë juridike, aq sa është aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vlerësimet e gjykatës në raport me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë

Paditësja me padi kërkon kthimin e mjeteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme dhe atë në shumën prej 43,225.00 euro, duke u mbështetur në nenit 27 paragrafi 2 të UA nr. 03/2013 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe nenit 38 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe nenit 7 të Kontratës ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Kjo mbështetur në pretendimet e paditëses se i padituri me rastin e paraqitjes së faturës nr. 75/13, datë 29.11.2013, ka mashtruar me çmimin real të traktorit të tipit Belarus 100KË, ku paditësja pretendon se çmimi real i tregut ka qenë shuma prej 33,000.00 euro.

Neni 27 i UA nr. 03/2013 në paragrafin 2 përcakton “Në rast të mashtrimit apo shkeljes së dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen sanksionet sipas nenit 38 Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, kurse neni 38 i të njëjtit Ligj i plotësuar/ ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-090 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë Dhe Zhvillimin Rural, parasheh “1. Ndëshkimet në rast të parregullsive, bëhen si vijon: 1.1 E tërë shuma e përkrahjes kthehet sipas ligjit.”

Neni 7 paragrafi 3 i Kontratës për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr. 47/2013 e datës 04.11.2013 e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, parasheh “Në rast të vërejtjes së ndonjë parregullsie në ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë rastet kur Përfituesi nuk është në gjendje që të bëjë pagesën apo ka falimentuar, ose nëse është vërejtur se dokumentet e ofruara janë të rreme/të skeduar/a/ jo të plota/nuk pasqyrojnë realitetin, atëherë AZHB-ja duhet të ndërpresë kontratën në kuptimin e njoftimit me shkrim adresuar Përfituesit, pa asnjë vonesë dhe pa asnjë formalitet tjetër juridik dhe pa ndërhyrje të ndonjë ligji të Gjykatës. Në rast të tillë përfituesi duhet të kthej tërë mbështetjen e marrë.”

Në rastin konkret për tu zbatuar ndëshkimet e parapara me nenin 27 të Udhëzimit Administrativ 03/2013 dhe nenit 38 të Ligjit të plotësuar/ ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-090 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë Dhe Zhvillimin Rural, duhet vërtetuar se në rastin konkret ka Mashtrim (ashtu siç pretendon paditësja) apo dhe shkelje të dispozitave të UA-së.

Në këtë çështje juridiko – kontestimore nuk është vërtetuar se këtu i padituri ka mashtruar paditësen lidhur me çmimin e shitblerjes së traktorit, kjo sepse fillimisht në procedurën penale të zhvilluar ndaj këtu të paditurit lidhur me veprimet e grantit lëndor, është refuzuar akti akuzues,

për shkak të parashkrimit absolut, me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit, me numër PA1.nr.510/2023 i datës 20.09.2023, e që bazuar në nenin 14 të LPK-së e cila parasheh *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”*, gjykata është lidhur vetëm me aktgjykimin penal me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

Kjo gjykatë edhe pse nga provat e administruara gjeti se ndaj të paditurit është përfunduar procedura penale me aktgjykim refuzues dhe jo dënues, vlerësoj elementet e mashtrimit jo në kontekstin e veprës penale, mirëpo mashtrimin të cilësuar sipas nenit 49 të LMD-së e cila përcakton *“Në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose mban në lajthim me qëllim që me këtë ta shtyj për lidhjen e kontratës, pala tjetër mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata edhe atëherë kur lajthimi nuk është thelbësor. 2. Pala që ka lidhur kontratë duke qenë e mashtruar, ka të drejtë që të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar.”*

Në gjendjen faktike të vërtetuar, del se i padituri A.N, për shitblerjen e traktorit kishte marre tri oferta sipas oferta me nr.351 e datës 14.11.2013, fatura nga Haxhi Jaha nr.236/13 dhe fatura nga “A.....” nr.119/13, ku oferta e dhënë sipas ofertës me numër 351 e datës 14.11.2013 ka qenë në shumën prej 71,000.00 euro, kurse nga fatura nr. 236/13 shuma e ofertuar e traktorit ka qenë 71,800.00 euro dhe fatura nga “A.....” nr. 119/13 shuma e ofertuar e traktorit ka qenë në shumën prej 52,000.00 euro, kështu që i padituri ka zgjedhur ofertuesin më të lirë dhe atë “A.....”, me ç ‘rast për shitblerjen e këtyre mjeteve kishin lidhur dhe kontratën e vërtetuar tek organi kompetent.

Bazuar në gjendjen faktike të tillë, në vlerësimin e gjykatës nuk plotësohen elementet e mashtrimit nga neni 49 i LMD-së, kjo sepse i padituri nga 3 oferta të paraqitura kishte zgjedhur ofertë më të lirë, shkresa këto të cilat e paditura me rastin e kontrollës i ka pasur parasysh dhe ka vazhduar me procedurën e tenderimit dhe se fakti se një operator ekonomik jep vlerën e një sendi më të lartë se operatori tjetër ekonomik, nuk paraqet fakt të mashtrimit, kjo sepse çmimet në tregun e Kosovës janë të rregulluara sipas parimit të ekonomisë së lirë të tregut.

Kurse sa i përket bazës juridike nga neni 7 të Kontratës së lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, kërkesëpadia e paditëses nuk gjen mbështetje në të njëjtën, kjo sepse kjo klauzolë përmban në vete disa elemente dhe atë vërejtjen e ndonjë parregullsie në ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë rastet kur Përfituesi nuk është në gjendje që të bëjë pagesën apo ka falimentuar, ose nëse është vërejtur se dokumentet e ofruara janë të rreme/të skeduar/jo të plota/nuk pasqyrojnë realitetin, dhe pastaj njoftimin me shkrim përfituesit të grantit për ndërprerjen e kontratës, dhe

pas plotësimit të këtyre kushteve në rast të tillë përfituesi duhet të kthej tërë mbështetjen e marrë, e që nga gjendja faktike e vërtetuar, nuk është plotësuar kushti i njoftimit me shkrim të përfituesit këtu të paditurin për ndërprerjen e kontratës, kjo sepse përmes leximit të kërkesës për kthim të mjeteve e datës 01.04.2014, është vërtetuar fakti se AZHB-ja i është drejtuar të paditurit me kërkesë për kthimin e mjeteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme, si dhe për shkak të ri kalkulimit të pagesave për traktor sipas listës së re të çmimeve të kthehen mjetet në shumën prej 16,022.50 euro dhe jo me njoftim për ndërprerjen e kontratës.

Përveç kësaj në raport me pjesën refuzuese, gjykata vlerëson të citojë dispozitën e nenit 7 të LPK-së e cila përcakton *“I Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* Lidhur me nenin 319 të LPK-së e cila parasheh *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.”*, ashtu që pala paditëse nuk ka pretenduar ndonjë fakt, përveç atyre të vlerësuara nga kjo gjykatë, si dhe nuk ka ofruar prova, me të cilat do vërtetonte faktet vendimtare mbi bazën e të cilave do gjente mbështetje kërkesëpadia e paditësit për pjesën e refuzuar.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit dhe atë shumën 27,202.50 euro, kjo sepse nuk është vërtetuar se kjo vlerë është fituar me veprime të kundërligjshme të paditurit, përkatësisht me veprimin e mashtrimit, ashtu siç ka pretenduar paditësja.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.03.2024, ka marrë aktvendim procedural me të cilin nuk ka lejuar kundërpadinë e të paditurit A.N e paraqitur ndaj palës paditëse Qeveria e Kosovës – Ministria e Bujqësisë, kjo sepse në petitumin e parashtrësës së të paditurit për paraqitjen e kundërpadisë përmban kërkesën ku decidivisht ceket *“Vërtetohet se pala paditëse – kundër e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Bujqësisë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, përkatësisht fitimin e humbur dhe dëmtimin e imazhit për të paditurin – kundër paditësin A.N për shkak të kallëzimit penal të pabazuar dhe mos mundësisë për shumë vite të aplikoj për grante dhe subvencione”*, e që në vlerësimin e gjykatës një kërkesë e tillë në krahasim me kërkesën e paditëses nuk paraqitet si kërkesë kodekse, prejudiciale apo dhe kompensuese, gjegjësisht e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet nga neni 256 paragrafi 1 pika a, b dhe c dhe paragrafi 2 të LPK-së.

Gjykata vlerësoj edhe provat tjera si raporti i vlerësimit për mallra dhe punime i datës 29.11.2013 dhe ftesa për kuotim e datës 14.11.2013, 13.11.2013, 11.11.2013; 16.11.2013, mirëpo të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën prej 7 % në vit e kërkuar me padi, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (03.06.2014), e gjerë në pagesën definitive, gjykata e bazoi në nenin 382 paragrafi 2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 450 dhe 463 të LPK-së, pasi që pala paditëse, si palë gjyq fituese nuk e ka specifikuar kërkesën për shpenzimet e kësaj procedure kontestimore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1630/2014, datë 03.05.2024

Gjyqtarja

Valentina Sopjani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.